

KESH sh.a HYRJE

07 JUN 2022

Nr. 2717 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË
INDUSTRIË DHE ENERGISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E ENERGISË
DHE EFIÇENCËN E ENERGISË

Nr. 3947/1 prot.

Tiranë, më 06.06.2022

Lënda: Dërgohet për trajtim kërkesa për informacion e znj.

KORPORATËS ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SH.A ✓

Blloku "Vasil Shanto", Tiranë

Pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është paraqitur kërkesa për informacion e znj. , protokolluar në MIE me Nr. 3947, datë 13.05.2022, ku kërkohet informacion dhe dokumentacion mbi projektin e hidrocentralit të Skavicës.

Për sa më sipër, bashkëlidhur ju përcjellim për trajtim, në përputhje me fushën e përgjegjësisë suaj, kërkesën për informacion të znj. duke kërkuar informimin e MIE-s për sa do të konkludohet nga ana juaj.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



KËRKESE PËR INFORMACION

3847
13 05 2

Emër Mbiemër: Z./Znj.	Adresa postare: <u>Rr. Skenderbej,</u> Shqiperi _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: 12/ 05/2022 Nënshkrimi: _____
--------------------------	---	--

Autoriteti Publik : Ministria e Infrastruktures dhe Energjise
Adresa: Rr. Abdi Toptani, Nr.4
Qyteti: Tirane

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Ne baze te ligjit per te drejten e informimit, si qytetare e Republikes se Shqiperise, lindur me _____, paisur me karte identiteti nr. _____, deshiroj te marr informacion dhe dokumenta mbi projektin HEC Skavica, faza e pare. Konkretisht, jam e interesuar te di dhe te kem dokumentat e meposhtem:

- Cilin version ka zgjedhur ministria, ne kuoten m=443 apo m=488 mbi nivelin e detit?
- Ne cilin stad ndodhet studimi i fizibilitetit dhe nese eshte i perfunduar, mund te kem nje kopje?
- Sa eshte numri i banoreve qe preken drejtperdrejt dhe sa e banoreve qe preken jo drejtperdrejt nga projekti HEC Skavica? Cilet jane zonat apo njesite administrative qe preken drejtperdrejt dhe jo drejtperdrejt?
- Cila eshte praktika e konsultimit paraprak me banoret ne fazat e fillimit te projektit dhe aktualisht? Ne detyrimin per konsultimin publik, cilet nga aktoret qe preken jane konsultuar, per shembull a jane ato banore qe preken drejtperdrejt, banore qe preken jo drejtperdrejt, nese jane aktore te shoqerise civile, perfaqesues lokale te njesive administrative etj? Cilet jane rezultatet e konsultimit publik dhe eshte e mundur te marr praktiken e ketij konsultimi nese eshte i perfunduar?
- Mundet te marr raportin nga kompania te gjetjeve te studimit hidrologjik, sedimentar, sizmiologjik dhe te tjera te kryera ne fazen e pare te projektit nga Bechtel?
- Jam e interesur te lexoj studimin e parafizibilitetit te kryer per kete projekt. Mundet te kem nje kopje te ketij raporti?
- Jam e interesuar te di cili eshte grupi negociator per fazen e pare dhe per fazen e dyte te ketij projekti dhe nese ne kete grup, eshte i perfshire nje perfaqesues i banoreve qe preken apo i qeverisjes lokale ne Diber?
- Sa eshte shuma totale e projektuar per demshperblim te banoreve?
- Cila do te jete menyra e demshperblimit te banoreve? A do tju jepen shtepi apo do te kompensohen me vlere monetare? Cfare roli do te luaja kontrata komerciale nese do te jete kjo forma ligjore ne lidhje me banoret per kete projekt?
- A jane marre parasysh mendimet e shoqerise civile, akademikeve dhe aktivisteve qe kerkojne nje projekt me me pak ndikim ne komunitet? A ka patur tryeza konsultimesh me eksperte dhe banore dhe a do te shikohet projekti per te patur me pak ndikim?

- Mundet të kem praktiken që ka çuar ministrinë e Infrastruktura në vendimin për të çuar në parlament një projektligj ku kërkohet autorizimi për negociimin e kontratës me Bechtel, nderkohe që me heret ministria ka thënë që do të ketë gare të hapur nderkombetare? Në cilin ligj është bazuar ministria për këtë vendim për të patur një ligj në parlament për këtë qëllim?

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Për përgjigjen e pyetjeve, dokumentat e kërkuar dhe praktiken shkresore (kopje) kërkoj që informacioni të më vihet në dispozicion në mënyrë elektronike në adresën e emailit: _____ Nëse nuk është e mundur, kërkoj që të më nisët me postë të adresa: _____ dyte, Tirane, nr celulari: _____

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/2020	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al, portalit *pyetshtetin.al* apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit *pyetshtetin.al*
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.